

## SHTETI LIGJOR NË SHQIPËRI: MIDIS ASPIRATËS DHE REALITETIT

**Dr. Gentian ZYBERI\***

### **Abstrakt:**

*Shqipëria hyri në rrugën e ndërtimit të demokracisë pas ndryshimeve të dhjetorit të vitit 1990. Duket qartë se, edhe pas tetëmbëdhjetë vjetësh tranzicion progresi i bërë në lidhje me konsolidimin e shtetit ligjor dhe sundimin e ligjit akoma mbeten në një nivel të pakënaqshëm.<sup>1</sup> Ndërmjet të tjerash, dy faktorët që kanë influencuar fuqishëm janë klima e ndezur politike që përgjithësisht ka zotëruar skenën politike shqiptare që nga vitet '90të dhe fryma e trashëguar klienteliste. Fatkeqësisht, influenca negative e këtyre dy faktorëve në ndërtimin dhe forcimin e institucioneve të pavarura dhe mirëfunksionuese në shërbim të qytetarit dhe zhvillimit të vazhdueshëm ekonomik e social vazhdon të ndihet edhe sot.*

*Në këtë punim autori nuk merr përsipër të bëjë një analizë të hollësishme të gjithë faktorëve që kanë influencuar procesin, por duket qartë që Shqipëria ka çaluar në ndërmarrjen e reformave të domosdoshme dhe në ngritjen e forcimin e shtetit ligjor. Krahas lirisë, të drejtave të njeriut, tregut të lirë, dhe demokracisë, sundimi i ligjit është një nga idealet të cilat shtetet sociale përpiqen t'i mbrojnë dhe konsolidojnë. Ky punim do të japë një pasqyrë të përgjithshme të shtetit ligjor dhe se çfarë ai nënkupton. Më pas theksi do të kalojë në kontekstin shqiptar. Çështja e forcimit të shtetit ligjor do të shihet dhe trajtohet si e lidhur ngushtë me reformën në drejtësi. Në këtë drejtim, domosdoshmëria e mirëfunksionimit të pushtetit gjyqësor, si një nga shtyllat kryesore të shtetit ligjor, dhe shkalla e reformës në këtë drejtim do të zënë një vend të konsiderueshëm. Në fund të punimit do të ofrohen disa konkluzione.*

**Fjalët çelës:** *Shteti ligjor, aksesimi në drejtësi, pushteti gjyqësor, reforma në drejtësi në Shqipëri.*

---

\* Dr. Gentian Zyberi (LL.M), Lektor në të Drejtë Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut, Instituti Hollandez i të Drejtave të Njeriut (SIM), Universiteti i Utrecht-it, Hollandë.

<sup>1</sup> Për këtë shih raportet kritike të Komisionit Europian lidhur me vlerësimin e Shqipërisë në lidhje me këtë pikë si dhe vlerësimin negativ të Shqipërisë në lidhje me nivelin e korrupsionit dhe probleme të tjera nga disa organizma ndërkombëtarë.

## 1. Koncepti i Shtetit Ligjor

Shteti ligjor apo sundimi i ligjit, përkthime të përafërta të termit anglisht ‘rule of law’, janë fjalë të shqiptuara dhe përdorura shpesh nga njerëz të profileve të ndryshme. Kur flitet për shtetin ligjor flitet për një sistem shtetëror ku sundimi i ligjit është një aksiomë. Ndërsa diskutimet mbi shtetin ligjor bëhen nga pikënisje e aspekte të ndryshme në këtë shkrim theksi mbetet në forcimin e shtetit ligjor si një kusht parësor për progres shoqëror si dhe për integrimin në strukturat euro-atlantike. Duhet përmendur që në krye që koncepti i ‘sundimit të ligjit’ *per se* nuk thotë asgjë rreth asaj se sa ‘i drejtë’ është vetë ligji apo ligjet, por thjesht se si sistemi shtetëror i përmbahet ligjit. Si një pasojë e kësaj, një shtet jodemokratik apo një që nuk respekton të drejtat e njeriut mund të ekzistojë me apo pa ‘sundimin e ligjit’, një situatë që reflektohet në disa diktatura moderne. Gjithsesi, sundimi i ligjit, shteti ligjor, apo ‘Rechtstaat’ konsiderohet si një parakusht për demokracinë dhe ka shërbyer si një platformë e përgjithshme për diskutimin rreth respektimit të të drejtave të njeriut.

Sundimi i ligjit është një ideal antik i parashtruar së pari nga Platoni si i bazuar në arsyen hyjnore dhe përbërës i rendit natyror. Ky koncept vazhdon të jetë i rëndësishëm si një ideal normativ, edhe pse akademikë ligjorë akoma kanë vështirësi që ta përkufizojnë atë. Kuptimi i sundimit të ligjit varion mes kombeve dhe traditave ligjore të ndryshme. Gjithsesi, përgjithësisht ai mund të kuptohet si një regjim politiko-ligjor nën të cilin ligji kufizon qeverinë duke promovuar disa liri dhe duke krijuar rregull dhe parashikueshmëri në lidhje me funksionimin e një vendi. Në sensin më të thjeshtë sundimi i ligjit është një sistem që tenton të mbrojë të drejtat e qytetarit nga përdorimi arbitrar dhe abuziv i pushtetit të qeverisë. Kështu, në traditën ligjore anglo-amerikane sundimi i ligjit është shikuar si një mburojë kundër despotizmit dhe si zbatim i kufizimeve ndaj forcës së qeverisë. Kohët e fundit sundimi i ligjit është konsideruar si një prej dimensioneve kyçe që përcakton cilësinë dhe mirëqeverisjen e një shteti. Kërkime si Indikatorët Botërorë të Qeverisjes e përcaktojnë sundimin e ligjit si: “masa në të cilën aktorët kanë besim dhe i zbatojnë rregullat e shoqërisë, dhe në veçanti cilësinë e zbatimit të kontratës, policinë dhe gjykatat, si dhe gjasat e kimit ose dhunës.” Bazuar në këtë përkufizim projekti Indikatorët Botërorë të Qeverisjes ka zhvilluar matje agregate për sundimin e ligjit në më shumë se 200 vende.

## 2. Elementët Themelorë të Shtetit Ligjor

Në librin e tij titulluar ‘Moraliteti i Ligjit’ shkollari amerikan i së drejtës, Lon Fuller, identifikon tetë elementë të ligjit që janë njohur si të nevojshëm për një shoqëri që aspiron të zbatojë sundimin e ligjit.<sup>2</sup> Këto elemente janë si vijon:

1. Ligjet duhet të ekzistojnë dhe këto ligje duhet të zbatohen nga të gjithë, duke përfshirë edhe punonjësit zyrtarë.
2. Ligjet duhen publikuar.
3. Ligjet nuk duhet të jenë retroaktivë. Për shembull, gjykata nuk mund të dënojë një person për një krim përpara se një normë penale me këtë efekt të jetë aprovuar.
4. Ligjet duhen shkruar me qartësi që të mënjanohet zbatimi i padrejtë.
5. Ligji duhet të mënjanojë kundërshtitë.
6. Ligji nuk duhet të urdhërojë të pamundurën.
7. Ligji duhet të rrijë konstant përgjatë kohës që të lejojë formalizimin e rregullave; gjithsesi, ligji duhet që të lejojë për rishikime kur rrethanat shoqërore dhe politike ndryshojnë.
8. Veprimet zyrtare duhet të jenë konsistente me rregullin e deklaruar.

Në vetvete këto tetë elemente mund të duken të qarta dhe të kuptueshme, por ato janë të vështira të zbatohen në realitet, sepse qeveritë janë të detyruara t’i japin përparësi një qëllimi ndaj një tjetri në një mënyrë të tillë që të reflektojë zgjidhjet politike të shoqërisë. Për shembull, të bërit e shumë ligjeve që janë shumë të detajuar dhe specifike mund ta bëjë një sistem shumë të ngurtë. Kjo ngurtësi mund të shkaktojë që gjykatat e një vendi (gjyqësori) të neglizhojë elementin njerëzor të çdo rasti të veçantë. Përveç kësaj, në vend që të aplikohen ligjet vetëm në të ardhmen, disa janë paracaktuar që të aplikojnë në mënyrë retroaktive, apo ndaj sjelljes të së kaluarës, sepse ato janë kaluar me qëllimin specifik për të korrigjuar sjelljen në fjalë. Edhe Fulleri vetë në shkrimet e tij i pranoi këto konflikte dhe sugjeroi që shoqëritë duhet të balancojnë objektivat e ndryshme të rreshtuar më sipër.

Kriteret e Fullerit janë të dobishme për të kuptuar sundimin e ligjit sepse ato përvijojnë llojet e rregullave, apo detyrimeve formale, që shoqëritë duhet të zhvillojnë në mënyrë që t’i qasen problemeve ligjore në një mënyrë që minimizon

---

<sup>2</sup> Lon L. Fuller, *The Morality of Law* (revised edition), Yale University Press, 1969, pp. 46-91.

abuzimin e procesit ligjor dhe pushtetit politik. Sundimi i ligjit, sidoqoftë, shtrihet përtej thjesht ca rregullave dhe rregullohet gjithashtu nga të ashtuquajturat ‘detyrimet institucionale’ mbi qeverinë që lihet të kuptohen nga elementët e Fullerit. Një detyrim i tillë është ekzistenca e një gjyqësori të pavarur; një tjetër është zhvillimi i mënyrave për të promovuar një ‘qeverisje transparente’. Detyrime informale, si kultura lokale apo traditat që mund të inkurajojnë qytetarët për të rregulluar sjelljen e tyre në përputhje me ligjin, gjithashtu ndihmojnë që të kufizojnë qeverinë, promovojnë lirinë, dhe kështu që të definojnë sundimin e ligjit. Megjithëse dukshëm i vagët, sundimi i ligjit mund të përkufizohet në mënyrë konkrete si një teori e qeverisjes që mbështetet në një seri detyrimesh ligjore dhe shoqërore që synojnë të inkurajojnë rregullin dhe të parandalojnë ushtrimin arbitrar dhe të paarsyeshëm të pushtetit të qeverisë.

### **3. Sundimi i Ligjit dhe Zhvillimi**

Institucione ndërkombëtare si Banka Botërore, Bashkimi Europian, dhe shumë politikanë në të gjithë botën besojnë se sundimi i ligjit promovon zhvillimin ekonomik. Për këtë arsye edhe disa prej tyre e lidhin dhënien e ndihmës apo e drejtojnë një pjesë të mirë të saj në konsolidimin e shtetit ligjor, apo sundimit të ligjit.

#### **A. Lidhja mes Sundimit të Ligjit dhe Zhvillimit Ekonomik**

Zhvillimi ekonomik modern vjen shpesh me futjen e një ekonomie tregu, ose të një ekonomie të bazuar në ndërmarrjet private që nuk bazohet në prodhimin e planifikuar nga qeveria. Max Weber, një sociologjisë dhe ekonomist i njohur, ka komentuar që rregulli kapitalist në të cilin bazohet një ekonomi tregu është organizuar në një shtet racional, të bazuar në ligje. Ekonomia e tregut sjell blerësit dhe shitësit në treg për transaksione komplekse dhe shitjen ndërkombëtare të të mirave. Në kohën e globalizimit, aktorët në një ekonomi tregu mund të vijnë nga pjesë të ndryshme të botës.

Ligji është i rëndësishëm për ekonominë e tregut sepse është baza e përbashkët në të cilin palët mund të bëjnë marrëveshje; ai u jep palëve besim se konfliktet do të zgjidhen në mënyrë eficiente dhe të drejtë. Për këtë arsye parashikueshmëria dhe rregulli që sundimi i ligjit promovon shihen si një forcë stabilizuese pas zhvillimit

ekonomik. Sundimi i ligjit ndihmon në fiksimin e ‘rregullave të lojës’ në fusha kritike si investime, prona, dhe kontrata.

Sundimi i ligjit shërben edhe si një garanci e rëndësishme për të drejtat shoqërore dhe për përgjegjësinë e qeverisë. Detyrimet e qeverisë janë veçanërisht kritike për shumë ekonomi në tranzicion ku një ekonomi e mëparshme e planifikuar do transformohet në një që bazohet në treg. Kur qeveria nuk është pronarja e vetme e tokës, kapitalit dhe krahut të punës sundimi i ligjit garanton që elementë themelorë të ekonomisë nuk do të preken nga veprime arbitrare të qeverisë. Sundimi i ligjit kështu siguron pjesëmarrësit e tregut që qeveria do të adoptojë një qëndrim të durave larg nga investimet dhe prodhimi, duke ju mundësuar pjesëmarrësve që të ushtrojnë plotësisht të drejtat e tyre në lidhje me tokën, krahun e punës dhe kapitalin.

## **B. Përbërës të Rëndësishëm të Reformave Lidhur me Shtetin Ligjor**

### **i. Reformat e Gjyqësorit**

Eficienca e gjyqësorit është një komponent i rëndësishëm në reformat e shtetit ligjor pasi ekzistenca e një gjyqësori të pavarur dhe të paanshëm është një aspekt themelor i sundimit të ligjit. Për shtetet që dilnin nga regjime komunistë krijimi i mjeteve eficiente për zgjidhjen e konflikteve ishte kyçe për t’ju përgjigjur kërkesave të një ekonomie të privatizuar. Në nivelin më të thjeshtë kjo nënkuptonte që gjykatat duhet të ishin aty për të zgjidhur çështjet dhe për të zbatuar vendimet. Për vende që janë në një fazë më të avancuar në këtë proces reforme ka nevojë për reforma më komplekse strukturore që forcojnë kapacitetin e gjyqësorit, pavarësinë, si dhe transparencën.

Për të rritur transparencën dhe përgjegjshmërinë sisteme të teknologjisë së informacionit duhet të instalohen në mënyrë që të rritet aksesin e publikut. Për të rritur pavarësinë e gjykatave qeveria duhet t’u japë atyre fondet që u lejon atyre të marrin vendimet e veta administrative dhe financiare. Më tutje, për vendet që i kanë zbatuar këto reforma strukturore, për të inkurajuar adoptimin e sundimit të ligjit rendimenti i gjykatave duhet vlerësuar në baza periodike. Pavarësia, përgjegjshmëria, Eficienca, aksesin, mundësia për t’ju drejtuar, mekanizmat e tjerë të zgjidhjes së konflikteve si dhe cilësia e profesionistëve janë disa prej karakteristikave që mund të japin një sistem matjeje të saktë të suksesit të sistemit.

### **ii. Rregullat Ligjore**

Një synim i rëndësishëm i reformës së sundimit të ligjit është që të krijojë një kuadër të plotë dhe të përshtatshëm ligjor. Siç e ka thënë edhe Fulleri ‘ligjet duhet të ekzistojnë’. Reformat ekonomike kanë gjeneruar një numër të madh ligjesh në vendet në zhvillim. Mes 1990 dhe 1995, 45 vende në zhvillim apo ish socialiste nxorën ligje të reja për investimet që mbulonin një numër të madh fushash. Shumë prej këtyre u kaluan që të liberalizoheshin regjimin e mëparshëm të investimeve në vendin në zhvillim duke ofruar mbrojtje të qartë dhe të gjerë ligjore për të gjitha llojet e investimeve. Në Kinë për shembull aktiviteti i përgjithshëm legjislativ kombëtar ka njohur rritje të vazhdueshme. Kjo rritje evidencohet nga fakti që numri i përgjithshëm i ligjeve, urdhëresave dhe ligjeve të amenduara u rrit në 360 në periudhën 1993-1998 nga vetëm 60 mes 1978 dhe 1993 – periudha kur reformat ekonomike filluan.

### **C. Inkurajimi Institucional në Nivel Global**

Për të inkurajuar zhvillimin shtesë specifik për një shtet në fillimin e viteve 1990 Banka Botërore dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN-ja) filluan që ta kushtëzonin ndihmën financiare në zbatimin e sundimit të ligjit në vendet marrëse. Këto organizata japin ndihmë për të mbështetur iniciativat në përgatitjen e legjislacionit, informacionit ligjor, edukimit publik dhe ligjor, dhe reformës së gjyqësorit duke përfshirë mënyrat alternative të zgjidhjes së konflikteve. Duke kushtëzuar fondet në institucionalizimin e sundimit të ligjit, Banka Botërore dhe FMN-ja gjithashtu shpresojnë të reduktojnë korrupsionin që minon zhvillimin ekonomik duke frikësuar investitorët dhe duke ndaluar rrjedhjen e lirë të të mirave dhe kapitalit.

Në Synimet e Zhvillimit të Mijëvjeçarit Kombet e Bashkuara gjithashtu përkrahin sundimin e ligjit si një mjet për të sjellë praktika më të pranueshme ambientale. Këto Synime janë tetë dhe Kombet e Bashkuara shpresojnë që t’i arrijnë deri në 2015 në një përpjekje për t’ju përgjigjur sfidave më të mëdha të zhvillimit botëror. Synimet u kërkojnë shteteve që të aprovojnë ligje në fusha të tilla si të drejtë ndërkombëtare mjedisi dhe energjie, si dhe një thirrje ndaj shteteve që të inkurajojnë qytetarët që të zbatojnë këto rregulla nëpërmjet ndryshimeve në zakone. Kombet e Bashkuara pranojnë haptas që arritja e Synimeve varet shumë nga zhvillimi i sundimit të ligjit, mes faktorëve të tjerë.

#### **4. Kriticizmi i Sundimit të Ligjit**

##### **A. Ligjet si Standardi i Qeverisjes**

Vetë termi ‘sundimi i ligjit’ sugjeron që vetë ligji është sovran, ose qeverisësi në një shoqëri. Si një ideal, sundimi i ligjit qëndron për pohimin që asnjë person apo pjesë e veçantë e qeverisë nuk mund të ngrihet mbi rregullat e bëra nga zyrtarë të zgjedhur politikë. Këto ligje reflektojnë moralin e një shoqërie, dhe në një demokraci perëndimore ata supozohet që të jenë të paravendosura, formalizuara, neutrale dhe objektive. Të gjithë u nënshtrohen atyre në të njëjtën mënyrë. Pra, sundimi i ligjit promovon barazinë nën apo para ligjit.

Kritikët e sundimit të ligjit, gjithsesi kanë vërejtur që ky sistem krijon një elitë qeverisëse që ka fuqinë që të manipulojë përmes ligjit. Ashtu si profesori i Harvardit dhe lideri i lëvizjes së studimeve kritike ligjore Morton J. Horwitz, ka sugjeruar, “duke promovuar drejtësi procedurale [sundimi i ligjit] lejon të zgjuarin, llogaritësin, dhe të pasurin që të manipulojë format e tij në avantazhin e vet.” Studiuesit që janë dakord me këtë deklaratë e shohin ligjin si ‘të papërcaktuar’, që domethënë ligji nuk ka një kuptim të qartë apo objektiv. Si rrjedhojë ligji nuk mund të shërbejë si një pengesë efektive ndaj abuzimit të pushtetit nga qeveria sepse strukturat e pushtetit në shoqëri, dhe jo vetë ligji, përcaktojnë rezultatin e çështjeve dhe problemeve ligjore.

Për arsye se interpretimi ligjor dhe zbatimi i ligjit influencohen nga elita udhëheqëse sundimi i ligjit nuk bën më shumë sesa të legjitimizojë ato marrëdhënie ligjore dhe struktura pushteti që ekzistojnë tashmë. Mungesa e rezultateve të paracaktuara së bashku me influencën e mundshme të elitës udhëheqëse domethënë që detyrimet e barazisë dhe parashikueshmërisë që sundimi i ligjit imponon janë të pamundshme për t’u arritur. Megjithatë sundimi i ligjit duket të jetë “objektiv”, që dmth zbatohet me drejtësi për të gjithë njerëzit, në të vërtetë zbatohet në mënyrë subjektive dhe të padrejtë. Teoria e sundimit të ligjit në këtë mënyrë ka fituar një legjitimitet të pamërituar në botën moderne.

Pjesërisht duke ju përgjigjur kriticizmit që u përvijua më sipër disa studiues kanë komentuar që pjesë e problemit me sundimin e ligjit është konceptimi i tij i ngushtë. Në vend që të shihet sundimi i ligjit vetëm si një libër rregullash i fokusuar ndaj gjyqësorit studiuesit duhet të fokusohen më shumë në detyrimet informale dhe institucionale që kufizojnë qeveritë. Për shembull kufizimeve morale dhe

tradicionale që shoqëritë imponojnë ndaj qeverisë duhet t'u jepen më shumë vëmendje në reforma dhe në konceptimin e përgjithshëm të sundimit të ligjit. Këto aspekte të sundimit të ligjit nuk i nënshtrohen të njëjtit manipulim. Ky konceptim më i gjerë mund të ndihmojë të mënjanohen situatat në të cilat elita ligjore manipulon ligjet sepse nga përkufizimi i tij sundimi i ligjit nuk varet vetëm nga gjyqësori, që shpesh reflekton forcën e elitës.

### **B. Kufizime Shtesë mbi Sundimin e Ligjit**

Ligjet shpesh janë të paafte që të ofrojnë standarde definitive të sjelljes për arsye të strukturave të tyre komplekse dhe ambiguitetit të pashmangshëm të gjuhës. Siç është përmendur më sipër kjo shpesh çon në një zbatim të paparashikueshëm të ligjit. Kritikë të sundimit të ligjit pretendojnë që për arsye të paqartësisë në rregulla në asnjë kohë nuk është një person plotësisht i mbrojtur brenda një sfere të lirive individuale. Për më tepër, sundimi i ligjit, nuk mund të lidhet drejtpërdrejt me nocione të përgjithshme të drejtësisë dhe paanësisë. Sundimi i ligjit kritikohet nganjëherë për atë që toleron rregulla jashtëzakonisht të padrejta, rregulla që godasin justifikimet teorike të sundimit të ligjit – promovimin e lirisë dhe kufizimin e qeverisë.

### **C. Ligji dhe Zhvillimi: Transplantet Ligjore**

Termi 'transplant ligjor' përshkruan fenomenin e huazimit të rregullave ligjore nga vende të tjera. Debatet akademike shpesh gravitojnë rreth implikimeve morale dhe praktike të transplanteve ligjore dhe, si shtesë, imponimin e sundimit të ligjit. Shumë vende në zhvillim duke përfshirë Kinën, Rusinë, Turqinë dhe Japoninë, që nga fillimet e viteve 1900 kishin tradita të ndryshme ligjore të vetat. Kur vende në zhvillim si këto adoptojnë ligje nga vende të tjera, rregullat e huazuara mund të mos i përshatën traditave bazë, kulturës, dhe kontekstit shoqëror të vendit në zhvillim. Për shembull demokracitë perëndimore tentojnë të fokusohen në të drejtat personale të cilat shumë persona i asociojnë me kapitalizmin. Për rrjedhojë, nocionet perëndimore të asaj çfarë përbën sundimin e ligjit reflektojnë këtë pikëpamje për botën. Struktura të tjera ligjore, sidoqoftë, mund të theksojnë detyrat ndaj komunitetit dhe përgjegjësitë. Përveç kësaj, në perëndim, zhvillimet ligjore ndodhën në të njëjtën kohë me zhvillimet shoqërore, politike dhe ekonomike, ndërsa në vende si Shqipëria krijimi i sundimit të ligjit është pasojë e ndryshimit të sistemi, dëshirës për t'u bërë

pjesë e strukturave euro-atlantike, dhe nevojës për të bashkëvepruar me shtete më të zhvilluara. Prandaj, ligjet e transplantuara mund të jenë në kundërshtim me norma kulturore, politike dhe shoqërore sepse ato nuk janë krijuar në të njëjtën kohë.

Transplantet ligjore janë veçanërisht të zakonshme në ligjet në fushën e ekonomisë si konkurrenca (antitrust), mbrojtja e konsumatorit, të drejtat e pronësisë intelektuale, si dhe rregullat e bursës dhe letrave me vlerë. Në këto ligje transplantet ligjore zakonisht krijojnë më pak polemika sesa në fusha të tjera të ligjit, si ato në të drejtën kushtetuese, administrative, apo familjare. Me sa duket kjo gjë ndodh sepse ligjet në fushën e ekonomisë përfshijnë koncepte si eficientia, stabiliteti, dhe parashikueshmëria e tregut, ndërsa ligjet jo-ekonomike mund të presin më thellë në kulturën e një shoqërie. Transplantimi i ligjeve në fushën e ekonomisë megjithatë kritikohet shpesh si të jetë një formë e kamufluar e shantazhit. Për arsye se shtetet perëndimore përgjithësisht kontrollojnë aksesin në tregun ndërkombëtar, në njëfarë mënyre shtetet në zhvillim duhet të pranojnë ligjet e shteteve të zhvilluara dhe kuptimin e sundimit të ligjit në mënyrë që të marrin pjesë efektivisht në aktivitetin ekonomik ndërkombëtar.

## **5. Reforma në Drejtësi**

### **A. Fokusi i Reformës**

Pushteti gjyqësor është një nga tre shtyllat kryesore të shtetit ligjor. Për vetë natyrën e këtij pushteti çdo iniciativë për reformë shihet me njëfarë dyshimi. Megjithatë, reforma në drejtësi në Shqipëri është kthyer në një temë e ditës duke nisur që prej shkarkimit të Prokurorit të Përgjithshëm. Natyrshëm lind pyetja: A është një fushatë radhe për politikën shqiptare reforma aktuale në drejtësi? Ndryshimet e realizuara në kryesimin e Prokurorisë së Përgjithshme, në anëtarësinë e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, emërtesat e reja nëpër gjykata dhe prokurori rrethesh, janë pjesa e vetme e dukshme e reformës. Ndërkohë, pakkush vëren që ndikimi real që këto lëvizje dhe këto ndryshime japin në procedurat reale, në praktikat e zakonshme të organeve të drejtësisë, në marrëdhëniet reale me qytetarët, është i papërfillshëm. Prej kohësh, media e shkruar dhe ajo audio-vizuale ndjekin seanca gjykimesh për kriminelë dhe banda, për privatizime dhe konflikte pronash që njihen dhe janë objekt konfliktesh me jehonë publike.

Aspekti tjetër, ai i burokracisë së hetimit dhe i gjykimit, dhe profesionalizimi i strukturave përkatëse është pak ose aspak i pranishëm në mediat tona. Në të vërtetë, është ky kryesisht ky element i administrimit të drejtësisë që fsheh brenda vetes deformimin dhe informalitetin real të drejtësisë institucionale. Në sallat e gjykimeve, në dosjet e proceseve të shtyra, në dosjet me dokumente të papranueshme dhe me taktika gjykimesh në serial, atje fshihet korrupsioni dhe abuzimi me drejtësinë. Fokusi i reformës në drejtësi duhet të jetë pikë së pari në aksesin e njerëzve në proceset e drejtësisë dhe në aspektet që u përmendën më sipër. Por me sa duket, kjo reformë duket se është shumë e vështirë për të mbërritur në këtë nivel konkretësie. Është për këtë arsye që skepticizmi ndaj reformave që ndërmerren, së pari si devizë dhe premtim politik dhe më pas si procedim institucional dhe administrativ, mbetet i pranishëm në gjykimet dhe vlerësimet e qytetarëve.

## **B. Probleme Lidhur me Shtetin Ligjor në Shqipëri**

Ndonëse dihej që rruga e ndryshimit të Shqipërisë nga një shtet totalitar në një shtet demokratik do të ishte e vështirë, mendohej që vështirësitë do të tejkaloheshin kryesisht nëpërmjet një kombinimi të vullnetit politik të faktorit të brendshëm dhe ndihmës ekonomike dhe teknike nga jashtë. Megjithatë, edhe pas tetëmbëdhjete vjetësh probleme themelore mbeten akoma pa u zgjidhur. Çështje kyçe si kthimi dhe kompensimi i pronave mbeten akoma të pazgjidhura përfundimisht dhe janë subjekt polemikash të vazhdueshme. Probleme të tjera që ndeshen dhe përmenden rëndom janë mosfunksionimi normal i institucioneve shtetërore, sidomos i administratës shtetërore në hallka të ndryshme. Kjo gjë ka rezultuar ndërmjet të tjerash në shërbimin jocilësor apo të munguar ndaj qytetarit, u ka hapur rrugë presioneve dhe lojërave politike në kurriz të pushtetit gjyqësor, si dhe ka krijuar premisat për një kuadër ligjor akoma të paplotë e të ngjashëm me një çarçaf gjithë arna, në adoptimin e të cilit përgjithësisht nuk merret fare parasysh mendimi i grupeve të interesit.

Në dyert e gjykatave shqiptare është shumëfishuar shprehja e thjeshtë qytetare: “As hasmin mos e pafsh këtu”! Duket thjesht si një zhargon, por ky urim buron si një deduksion prej dhimbjes, vuajtjes, dhe pse jo edhe kalvarit që ndodh pas dyerve të gjykatave. Nuk ka nevojë për shumë mend që të kuptohet se ka shkelje procedurash dhe ligji kur një person mbetet prej më tepër se tre muaj në qeli, në ndjekje të procedurave shtyrëse dhe hetuese për masën e sigurisë. Për më tepër janë tronditës

fakte të tilla flagrante kur eksperti që vlerëson dëmin apo krimin ekonomik të shkaktuar në një rast nga prerja e pyjeve, nuk është as inxhinier pyjor e as ekspert kullotash, por zooveteriner! Administrimi i drejtësisë është përgjegjësi e madhe publike që nuk mundet të degjenerojë në një “turp të radhës” të drejtësisë shqiptare. Kalvari i pafund i njerëzve të thjeshtë në mjediset e institucioneve të drejtësisë mbetet një pasqyrë e shërbimit të munguar ndaj qytetarëve dhe të pamundësisë së rivendikimit të së drejtës së tyre nëpërmjet këtyre organeve. Në këto kushte reforma është e dënuar që të shtojë skeptikët, pasi ajo nuk mund të tjetërsojë realitetin tronditës.

Sa është aspiratë dhe sa realitet konsolidimi i shtetit ligjor në Shqipëri? Në qoftë se mendohet se vendimet e Komisionit të Shërbimit Civil për rikthim në detyrë të punonjësve të pushuar padrejtësisht janë lënë në fuqi në mbi 92 për qind të rasteve nga gjykatat e apelit dhe si të tilla janë shndërruar në tituj ekzekutivë kjo tregon se ka diçka që nuk shkon në mirëfunksionimin e administratës. Ky shqetësim shtohet shumëfish kur merr vesh se shkalla e rivendosjes së të drejtës së këtyre nëpunësve, pra rikthimi i tyre në detyrë, është e nivelit zero. A është ky shteti ligjor të cilin ne duam që të ndërtojmë dhe forcojmë? Shembujt flagrantë të këtij lloji si dhe të emërimit në punë të personave në bazë militantizmi partiak apo lidhjesh farefisnore janë shqetësues edhe sikur të numërohen me gishta.

Po cili është rezultati i mosrespektimit të shtetit ligjor? Nga njëra anë taksapaguesit shqiptarë paguajnë nga xhepat e tyre qindra e mijëra nëpunës të shkarkuar për motive politike, të cilët për këtë shkak kanë fituar të drejtën e tyre të ligjshme të paguhen për një vit rresht ose të rrinë në listë pritje pra të paguhen, pa punuar. Nga ana tjetër dalëngadalë kështu formatohet një administratë e paaftë e për rrjedhojë edhe e korruptuar dhe jo efiçente, që pastaj bëhet barrierë dhe taksidare e biznesit. Kjo lloj politike cënon xhepat e qytetarëve taksapagues si dhe të ardhmen evropiane dhe perspektivën për një jetë më të mirë për të gjithë qytetarët shqiptarë.

### **C. Propozimet Lidhur me Reformën në Drejtësi**

Reformat në drejtësi që janë diskutuar deri më tani prekin si gjyqësorin ashtu edhe prokurorinë. Kështu, janë hedhur për diskutim një sërë propozimesh që prekin direkt interesat dhe kompetencat e organit të akuzës. Ulja e pagave në masën 30 për qind,

heqja e së drejtës për pushimin ose mosfillimin e procedimit penal, zhveshja e prokurorëve nga imuniteti, si dhe e drejta për kallëzim penal ndaj Prokurorit të Përgjithshëm janë disa nga ndryshimet e pritshme. Përpyekjet e politikës për të nënshtuar ose të paktën zbutur organin e akuzës, të pasqyruara edhe në deklarata të përfaqësuesve të mazhorancës që shigjetojnë drejtpërdrejt Prokurorinë e Përgjithshme, pritet të zyrtarizohen me një ligj të ri, i cili zvogëlon kompetencat e këtij institucioni. Propozimet e mësipërme pritet të jenë pjesë e diskutimeve për hartimin e projektligjit të ri për “Organizimin dhe funksionin e prokurorisë”. Miratimi i tyre do të zhvishte përfaqësuesit e organit të akuzës nga një sërë atributesh që kanë aktualisht. Përveç uljes së pagës në masën 30 për qind për gjithë sistemin e akuzës, përfshi Prokurorin e Përgjithshëm, si dhe heqjen e së drejtës për vendimin e pushimit dhe mosfillimin e procedimit penal e zhveshjen e prokurorëve nga imuniteti, ky ligje mendohet që t’u japë të drejtën qytetarëve të bëjnë kallëzim penal ndaj prokurorëve, duke mos përjashtuar as Prokurorin e Përgjithshëm.

Siç u përmend më sipër pikat më të nxehta që pritet të ndryshohen në ligjin për prokurorinë, sipas burimeve nga institucioni i akuzës, prekin drejtpërdrejt jo vetëm sistemin e prokurorisë, por dhe vetë prokurorët. Çështja më e diskutueshme është reduktimi i pagave të prokurorëve në masën 30 për qind, duke përfshirë dhe Prokurorin e Përgjithshëm. Aktualisht paga e një prokurori pranë Gjykatës së Shkallës së Parë është e barabartë me pagën e një gjyqtari të kësaj shkalle, dhe nëse miratohet ky propozim, prokurori do të paguhet 30 për qind më pak se gjyqtari. I njëjti parim vlen edhe për Prokurorin e Përgjithshëm, paga e të cilit aktualisht është e barabartë me kryetarin e Gjykatës së Lartë. Kjo prek drejtpërdrejt parimin e pavarësisë së organeve që administrojnë drejtësinë.

Mbrojtja e prokurorit është një pikë tjetër e cila pritet të ndryshohet. Me propozimet e reja, prokurori mund të ndalohet, kontrollohet ose arrestohet pa marrë leje nga Prokurori i Përgjithshëm. Sipas ligjit aktual, në rast se kreu i akuzës nuk jep pëlqimin brenda 24 orësh organet përgjegjëse janë të detyruara të lirojnë prokurorin. Kallëzimi penal ndaj prokurorëve është një çështje që mund të rrezikojë seriozisht pozicionin e prokurorit. Me propozimet për ligjin e ri, sipas burimeve, u jepet e drejta të gjithë qytetarëve të bëjnë kallëzim penal kundër prokurorit, i cili pezullohet automatikisht. Miratimi i këtij ndryshimi do të prekë edhe Prokurorin e Përgjithshëm, i cili me ligjin aktual emërohet dhe shkarkohet nga presidenti me pëlqim të Kuvendit.

#### **D. Makiazh apo Ndryshime Rrënjësore**

Propozimi për heqjen e së drejtës së prokurorit për të pushuar apo mosfilluar një procedim penal, duke ia kaluar këtë kompetencë gjykatës, është nga ato që krijojnë polemika. A është një ndryshim i tillë në ligjin për prokurorinë një ndryshim radikal? Në të vërtetë çfarë kjo nënkupton është thjesht heqja e diskrecionit të prokurorit në fillimin apo jo të procesit penal duke ja nënshtuar këtë kontrollit të gjykatës. Kjo gjë nuk kërkon ndryshimin e gjithë sistemit ligjor. Ka disa vende që ku hetimet paraprake ndiqen nga një gjyqtar, *juge d'instruction*, i cili merr të gjithë vendimet për një procedim penal të caktuar, përfshi edhe pushimin e procedimit. Në Shqipëri hetimet paraprake ndiqen nga prokurori, i cili ka të drejtën e pushimit ose mosfillimit të procedimit penal.

Paga e Prokurorit të Përgjithshëm është e barabartë me pagën e kryetarit të Gjykatës së Lartë ndërsa paga e prokurorit është e barabartë me pagën e gjyqtarit të gjykatës pranë së cilës funksionon prokurori ku ai është emëruar. Me propozimet për ndryshim paga e prokurorit ulet në masën 30 për qind. Sipas nenit 24 të Kodit të Procedurës Penale, neni 24, pika 2, thuhet se prokurori ka të drejtë të mos fillojë ose të pushojë procedimin penal në përputhje me kodin. Me propozimet për ndryshim kjo kompetencë i kalon gjykatës. Prokurori mund të pezullohet nga detyra, kur ndaj tij fillon një procedim penal deri në përfundimin e procedimit. Kur zbulohen shkelje të rënda disiplinore Prokurori i Përgjithshëm i propozon Presidentit të Republikës shkarkimin e prokurorit nga detyra. Me propozimet për ligjin e ri, prokurori pezullohet automatikisht nga detyra në rast se ndaj tij depozitohet një kallëzim penal.

Ky propozim prek edhe kreun e akuzës, duke i dhënë të drejtë çdo qytetari që të depozitojë kallëzim penal për Prokurorin e Përgjithshëm. Sipas ligjit të tanishëm Prokurori nuk mund të ndalohet, kontrollohet ose arrestohet pa pëlqimin e Prokurorit të Përgjithshëm, përveç rasteve kur kapet duke kryer një krim. Në qoftë se Prokurori i Përgjithshëm brenda 24 orësh nuk jep pëlqimin për dërgimin në gjykatë të prokurorit, organi përgjegjës është i detyruar të lirojë prokurorin. Kjo pikë është propozuar të ndryshojë, duke shmangur miratimin nga Prokurori i Përgjithshëm. Sipas propozimit, policia mund të ndalojë, kontrollojë ose arrestojë prokurorin, pa pasur nevojë për pëlqimin e Prokurorit të Përgjithshëm. Natyrshëm që ndryshime të tilla janë mjaft

radikale dhe krijojnë një tension mes dy pushteteve, përkatësisht atij gjyqësor dhe atij ekzekutiv. Nga ana tjetër qenia prokuror apo gjyqtar nuk mund të përdoret si mburojë për t'i shpëtuar përgjegjësisë ligjore për veprime antiligjore.

### **E. Trysnia mbi Pushtetin Gjyqësor në Shqipëri**

Gjyqësori në Shqipëri ka qenë dhe vazhdon të jetë nën tryshninë e politikës ndërsa kësaj të fundit i mungon vullneti për të kryer reformën në drejtësi. Shembulli më i qartë i tryshnisë së politikës ndaj gjyqësorit ose efektit negativ të kapriçove të politikës mbi gjyqësorin janë zgjedhjet e fundit që po bëhen në të gjitha shkallët e këtij sistemi. Një shembull që ilustron këtë më së miri është refuzimi i kandidaturës së z. Traja, ish gjyqtar i Gjykatës Europiane të Drejtave të Njeriut, për pozicionin e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë. Reforma në drejtësi prej kohësh është kryefjala e politikës shqiptare, por pas një vrulli fillestar duket se ajo ka mbetur vendnumëro, pasi me përjashtim të ligjit për organizimin e gjyqësorit, asnjë hap tjetër nuk është hedhur akoma në këtë drejtim. Fatkeqësisht, reforma në drejtësi ka ngecur në kuadrin e lojërave të fjalëve mes aktorëve politikë. Nga ana tjetër, strukturat që drejtojnë dhe menaxhojnë pushtetin gjyqësor më tepër i kushtojnë rëndësi anës mediatike, se sa anës funksionale, për t'ju përgjigjur asaj që kërkon reforma, që është që pushteti gjyqësor të luajë atë rol që ka sipas kushtetutës dhe ligjeve përkatëse, atë të dhënies së drejtësisë. Gjithë përgjegjësia e atyre që menaxhojnë pushtetin gjyqësor ka të bëjë jo vetëm me aspektin ndërkombëtar, për të plotësuar ato detyrime që ne kemi përpara institucioneve dhe organizmave ndërkombëtare, por në radhë të parë për ta vënë atë në eficiencë, për t'i shërbyer zhvillimit të vendit dhe nevojave të qytetarit.

Padyshim që ndikimet politike të çfarëdo krahu qofshin ato nuk janë në të mirën e reformimit të këtij sistemi. Shembulli më i qartë i këtij ndikimi politik, siç edhe u përmend më sipër janë proceset e emërimeve nëpër gjykata të niveleve të ndryshme, në Këshillin e Lartë të Drejtësisë, në Gjykatën e Lartë apo edhe në Gjykatën Kushtetuese. Janë vetë grupimet politike që përdorin vendimet e Gjykatës Kushtetuese sipas interesave të tyre të momentit. Për shembull, kur interpretojnë një problem të caktuar, ata i referohen një vendimi të Kushtetueses, ndërsa kur një tjetër vendim i kësaj gjykate nuk u vjen për shtat, ata fillojnë dhe e konsiderojnë këtë institucion si të manipuluar, jo profesional, të korruptuar, e me mjaft etiketime të tjera. Të gjitha këto indicie bëjnë që të krijohet bindja se në Shqipëri aktorët politikë

kryesorë nuk kanë vullnetin e duhur politik për ta bërë reformën në drejtësi. Zgjedhja e kryetarëve të gjykatave të rretheve nuk i shpëtoi dot politizimit të KLD-së. Kështu, ndonëse u zhvillua një proces formal ku u thirrën dhe u dëgjuan platformat e kandidatëve për kryetarë, procesi i votimit nuk u bë transparent, procesi i vendimmarrjes nuk u zbardh. Atëherë si mund të besohet në një proces të tillë edhe sikur rezultatet të jenë korrekte? Duke pasur parasysh mënyrën se si votohet, ndoshta duhet parë edhe Kushtetuta, por KLD-ja duhet të rregullohet urgjentisht, sepse ka në dorë përgjegjësi të mëdha lidhur me menaxhimin e pushtetit gjyqësor.

Pushteti gjyqësor është një pushtet që administron drejtësinë dhe vë në vend drejtësinë duke ndarë të drejtën nga e padrejta. Një nga treguesit e shëndetit të këtij pushteti është se sa u rezistojnë vendimet shkallëve dhe niveleve të ndryshme të gjykimit. Çelësi për ta vënë përpara përgjegjësisë gjyqësorin është analiza profesionale e vendimeve. Pra, në qoftë se një vendim qëndron në fuqi deri në Gjykatën e Lartë, atëherë ai në një rrjedhë normale të procesit ligjor do të marrë formë të prerë. Ndërsa mund të gabojë një apo dy shkallë të gjyqësorit, sistemi vetë ofron mundësinë për korrigjim. Pavarësisht besimit të ulët që gëzon pushteti gjyqësor në publik nuk mundet që gjyqtarët t'i etiketojmë dhe t'i grupojmë si të korruptuar. Korrupsioni ka emër dhe duhet të ketë përgjegjësi individuale.

Një nga problemet kryesore të gjyqësorit është menaxhimi i tij, çka është vështirësuar edhe më shumë me ndryshimet që u bënë me ligjin “Për organizimin e pushtetit gjyqësor”, ku bishti është bërë më i rëndë se sqepari. Me këtë ligj i është dhënë një rol më i madh kancelarit dhe trupës ndihmëse administrative të gjyqësorit, në një kohë që gjykatat kanë përgjegjësinë kryesore. Përgjegjësia e gjyqtarit fillon që tek procesverbali, ku pasqyrohen gjithë thëniet e palëve në proces dhe ky procesverbal është në dorë të njerëzve që nuk kanë të njëjtën përgjegjësi. Por në gjyqësorin shqiptar një tjetër problem është ai i sistemit të shpërblimeve. Ka gjyqtarë që kanë për shqyrtim 100 apo 200 çështje dhe ka gjyqtarë që kanë 30-40 çështje; ose ka gjyqtarë që kanë ngarkesë të plotë, por çështjet e tyre më së shumti janë zgjidhje martesash, që janë çështje të lehta. Niveli i shpërblimit të tyre është i njëjtë, pagesa e tyre është e njëjtë. Ndoshta ka ardhur koha që të stimulojmë gjyqtarët më racionalë me shpërblime më të larta, çka mund të influencojë pozitivisht për të pasur më shumë stimul pune.

Infrastruktura dhe shtrirja gjeografike e gjykatave mbetet një problem më vete. Me ndryshimet e fundit që janë bërë, janë krijuar rrethet gjyqësore, por po të shihet me vëmendje, këto kanë krijuar shumë probleme në praktikën e përditshme të punës, në zvarritjen e proceseve, në lëvizjen e gjyqtarëve, në menaxhimin e sekretimit të dosjeve, por edhe në problemet që hasin personat që kanë interesa përpara kësaj trupe gjyqësore, të cilët humbasin shumë kohë, sepse duhet që një qytetar nga Përmeti të shkojë në Gjirokastrë, ose në Tepelenë. Kjo zgjidhje është shembull i një sistemi të propozuar nga një grup specialistësh të huaj të zbatuar me nxitim pa u analizuar në kuadrin e kushteve shqiptare. Ky është një shembull i rënies në tendencën që çfarë na thonë specialistët e huaj e marrim për të mirëqenë, pa marrë mendimin e specialistëve vendas apo të grupit të prekur nga ligji përkatës. Pjesë e reformës në drejtësi mund të jetë edhe rishikimi i shtrirjes së gjykatave të apelit.

#### **E. Korrupsioni i Gjyqësorit**

Për hir të së vërtetës duhet pranuar se ka individë të veçantë të gjyqësorit që janë të korruptuar dhe kjo është më se logjike, pasi gjyqësori është pjesë e të tërës, është pjesë e një sistemi shqiptar, që akoma ka vështirësi të shkëputet nga mentalitete të vjetra. Por në këtë trupë gjyqësore ka shumë gjyqtarë të ndershëm, profesionalistë shumë të mirë dhe të përkushtuar. Ndonëse thuhet vetëm se gjyqësori është i korruptuar, nuk thuhet se si mund të zgjidhet ky problem. Korrupsioni në drejtësi ashtu si dhe në fusha të tjera në të vërtetë nuk është e vështirë të zbulohet. Korrupsioni ose paaftësia në gjyqësor zbulohen shumë thjesht nëpërmjet analizës së vendimeve të formës së prerë. Në qoftë se një gjykatës ka dhënë dy vendime të kundërta për çështje të njëjta, atëherë ose është i paaftë dhe duhet të largohet, ose është i korruptuar dhe sërish duhet të largohet. Përfshirja në bllok e të gjithë trupës gjyqësore nuk është e drejtë. Lufta ndaj korrupsionit në rradhët e gjyqësorit ka nevojë të precizohet dhe të individualizohet dhe personat të ndëshkohen sipas përgjegjësisë individuale.

#### **F. Avokatia dhe Reforma në Drejtësi**

Avokatia në Shqipëri ka filluar realisht nga funksionimi në vitin 2000. Ky institucion erdhi nga një periudhë vakumi për gati 30 vjet, kohë gjatë së cilës ky profesion nuk është ushtruar. Për këtë arsye ajo nuk trashëgoi as eksperiencën e nevojshme

profesionale dhe as atë etike e morale. Në vitin 2000 avokatët filluan të organizohen duke paguar kuotat dhe duke evidentuar të ardhurat. Ndryshime të tjera përfshijnë veshjen e veçantë dhe serioze, përdorimin e kartave të identitetit, dhe provimin për marrjen e licencës së avokatëve. Ky organizim kulmoi me ligjin e vitit 2003, që u bë me ndihmën e Këshillit të Evropës, nëpërmjet specialistëve të huaj. Në ligjin e 2003-it është adaptuar një sistem të procedurave për masat disiplinore ndaj avokatëve, të cilët gjatë procesit hetimor dhe gjyqësor shkelin kodin e etikës lidhur me paraqitjen e avokatit në këto procese. Për fat të keq probleme vazhdojnë të ekzistojnë. Ka avokatë që zvarrisin gjyqet, ka prej tyre që luajnë edhe rolin e sekserit, ka avokatë që nuk paguajnë tatime, ka që nuk prezantohen me dinjitet nëpër procese e kështu me rradhë. Megjithatë nuk duhet harruar se avokacia në Shqipëri ushtrohet në kushte të tejskajshme vështirësie. Kështu, si në të gjithë botën edhe ne e kemi të detyruar me ligj që avokatit t'i vihet në dispozicion çdo dokument nga institucionet shtetërore, shoqatat jofitimprurëse, apo edhe subjektet private, për nevojat e procesit, por ky detyrim ligjor pak gjen zbatim.

Nuk duhet harruar gjithashtu që mungesa e traditës bën që zakonisht avokati të jetë pala e diskriminuar në proces. Në qoftë se hyjmë në një proces penal, ku prokurori dhe avokati paraqesin secili kërkesa paraprake, avokatit rrallë mund t'i pranohet ndonjë kërkesë, kurse prokurorit do t'i pranohen pothuajse të gjitha. Specifika tjetër që anashkalohet shpesh në analizën e institucionit të avokatit është që avokati nuk jep drejtësi, që do të thotë se është gjykata ajo që ndan të drejtën nga e padrejta. Dhe në qoftë se gjykata është në atë shkallë profesionalizmi dhe ndershmërie që duhet, nuk ka avokat që ta korruptojë. Megjithatë nuk janë të pakta rastet kur avokati çështje të cilat i ka të sigurta i humbet, ndërsa çështje që nuk ka shpresa t'i fitojë, por thjesht shkon të përfaqësojë klientin dhe i fiton. Absurditete të tilla ndodhin sepse gjyqësori është ose nën trysninë politike, ose nën trysninë shtetërore, ose në trysninë e klaneve dhe atyre që e zgjodhën, ose nën trysninë financiare të korrupsionit. Kjo është një shenjë e mosfunksionimit të shtetit ligjor dhe mosrespektimit të ligjit.

Megjithatë përgjegjësia i mbetet Dhomës Kombëtare të Avokatisë për mosmarrjen e masave disiplinore në prani të kërkesave për këtë qëllim nga klientët, gjyqtarët, apo edhe Ministria e Drejtësisë. Në ligjin aktual parashikohen disa procedura të zgjatura, të cilat e ndërlikojnë problemin. Duhet që këto procedura të bëhen sa më fleksibile.

Kështu që lind nevoja që kjo pjesë e ligjit që shihet se nuk funksionon si duhet të rishikohet. Puna e avokatit është më e ndërlikuar, për shkak të marrëdhënies që ai ka me klientin. Për shembull, në rastin e Gjykatës së Krimeve të Rënda, ku paraqiten çështje të vështira, avokati është nën trysinë edhe të urdhrave të klientit apo familjarëve të tij. Nëse ata i kërkojnë atij që të mos paraqitet në gjyq, pozita e tij është shumë e vështirë. Kjo çështje duhet të zgjidhet nëpërmjet parashkrimit në ligj, por jo të kalohet apriori përgjegjësia tek avokati, i cili ndodhet në një pozitë të vështirë pasi ai nuk mund të konfliktohet me klientin.

### **G. Nevoja për një Kornizë për Reformën në Drejtësi?**

Si mund të realizohet reforma në drejtësi? Cilat duhet të jenë parametrat e kësaj reforme? Siç dihet pranimi i Shqipërisë në Bashkimin Europian varet nga përmbushja e kriterëve të Kopenhagenit: stabiliteti i institucioneve që garantojnë demokracinë, të drejtat e njeriut dhe respekti për dhe mbrojtja e minoriteteve, si dhe natyrisht, sundimi i ligjit. Pra, është e vërtetë që vendi ka nevojë më shumë se kurrë për bërjen e kësaj reforme edhe për shkak se shteti ligjor është një parakusht themelor për anëtarësimin e vendit në BE dhe NATO. Reforma në drejtësi nënkupton që Kuvendi i Shqipërisë duhet të nisë punën për përfundimin e kësaj reforme sipas një pjesëmarrjeje me bazë të gjerë. Për këtë qëllim Komisioni Parlamentar për Reformën në Drejtësi, i ngritur me vendim të Kuvendit, duhet të fillojë sa më parë nga puna. Pak muaj më parë, mazhoranca dhe opozita pas diskutimeve të gjatë në Komisionin e Ligjeve arritën të miratojnë disa ndryshime vetëm në ligjin për organizimin dhe funksionimin e sistemit gjyqësor. Megjithatë, para së gjithash është i nevojshëm krijimi i një marrëdhënieje të re mes politikës dhe drejtësisë, që duhet të shënojë mbylljen përfundimtare të një raporti të vështirë mes tyre, të një raporti të ngritur shpesh mes klientelizmit dhe shërbesës së ndërsjellë jashtë parimeve dhe vlerave që sistemi i drejtësisë duhet të bartë.

### **6. Konkluzione**

Siç dëshmon edhe dështimi i përpjekjeve për të arritur në një përkufizim të saktë sundimi i ligjit është një teori e komplikuar. Po aq sa ajo trupëzon politikën dhe idealet e demokracisë, një kuptim i plotë e kësaj teorie duhet të përfshijë ndërveprimin e ligjit me gjuhën, historinë, strukturat shoqërore, dhe kulturën. Është me rëndësi të theksohet që sundimi i ligjit është më shumë se një grumbull rregullash dhe aplikimi

ligjor i tyre. Si një teori e shumë-mbrojtur në studimet e zhvillimit sundimi i ligjit është gjithashtu një çështje e bërjes së politikave, zhvillimit institucional, dhe politikave ndërkombëtare. Në rastin e Shqipërisë, sundimi i ligjit dhe reforma në drejtësi janë të lidhura ngushtësisht. Konsensusi mes forcave politike për nevojën për reformën në drejtësi është me rëndësi në mënyrë që ky proces të zhvillohet me hapin e duhur. Ndërsa hapi i parë në këtë drejtim është bërë me miratimin e mendimeve të ligjit mbi pushtetin gjyqësor ka një marrëveshje që në mënyrë që kjo reformë të jetë efektive ajo duhet të jetë më e gjerë. EURALIUS, një program i Komisionit European do të kontribuojë në këtë drejtim duke dhënë mbështetjen e tij për të gjithë elementët e reformës.

Ndonëse marrëveshja e forcave politike është një parakusht për progres në këtë drejtim ajo nuk mjafton që reforma në drejtësi të përmbushet me sukses. Konsensusi mbi parimet duhet të shoqërohet me një konsultim të gjerë me aktorët kryesorë që preken nga kjo reformë gjatë përgatitjes së legjislacionit dhe një debat i gjerë dhe i plotë nga Kuvendi. Një proces i tillë do të rezultojë në një legjislacion që jo vetëm duket mirë por edhe mund të zbatohet në praktikë, pra, në një legjislacion që do ketë impaktin e dëshiruar në realitet. Sundimi i ligjit është një parakusht themelor për anëtarësinë e Shqipërisë në BE. Vendosija e mekanizmave që lejojnë sundimin e ligjit të zbatohet ashtu si duhet është një detyrë themelore e të gjitha forcave politike si dhe e shoqërisë civile, duke përfshirë këtu edhe potencialet njerëzore të angazhuara ndërmjet të tjerash edhe në Institutin Alb-Shkenca.